



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE**  
**KËSHILLI DREJTUES**

Nr. Prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**VENDIM**

**Nr. 23, datë 19.09.2023**

**PËR**

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE**  
**NË VENDIMIN E KËSHILLIT DREJTUES NR. 17, DATË 28.07.2016 “MBI**  
**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR POLITIKËN E ADMINISTRIMIT TË**  
**MJETEVE FINANCIARE TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “ll” dhe shkronja “m”, të nenit 52, pika 1, shkronja “i”, të nenit 59, pika 1 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, si dhe të nenit 8, shkronja “l” të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016 “Mbi miratimin e Rregullores për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 18 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Komitetit të Investimeve të Agjencisë sipas vendimit të tij nr. 8, datë 14.09.2023, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I:**

I. Në Rregulloren “Për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 4, togfjalëshi “të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 28, datë 03.11.2014” zëvendësohet me togfjalëshin “të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018 dhe/ose çdo akti ndryshues të tij”.
2. Në nenin 5, në shkronjat “c”, “d”, dhe “e” togfjalëshi “në rregulloren “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 26, datë 16.10.2014” zëvendësohet me togfjalëshin “në rregulloren “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 25, datë 31.10.2018 dhe/ose çdo akti ndryshues të tij”.





3. Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

a. Pika 3 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“3. Komiteti ka në përbërjen e tij shtatë anëtarë me të drejtë vote, si më poshtë:

- Drejtorin e Përgjithshëm, në cilësinë e Kryetarit të Komitetit;
- Zëvendës Drejtorin e Përgjithshëm, në cilësinë e Zëvendës Kryetarit të Komitetit, i cili caktohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm;
- Përgjegjës in e Sektorit të Financës dhe Investimeve, në cilësinë e anëtarit;
- Përgjegjës in e Sektorit të Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, në cilësinë e anëtarit;
- Kryespecialistin e Investimeve në Sektorin e Financës dhe Investimeve, në cilësinë e anëtarit;
- Përgjegjës in e Sektorit të Analizës së Riskut, në cilësinë e anëtarit;
- Kryespecialistin e Sektorit të Analizës së Riskut, në cilësinë e anëtarit.”

b. Në pikën 5 hiqet fjalia e dytë.

c. Në pikën 8, fjalia e parë ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“8. Kuorumi për marrjen e vendimeve nga Komiteti i Investimeve është 4 vetë, me kusht që të paktën dy nga tre sektorët (SFI, SAR, SSKD) dhe Drejtori i Përgjithshëm, ose në mungesë të tij Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm, të jenë të përfaqësuar.”

ç. Pika 9 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“9. Vendimi i Komitetit nënshkruhet nga Kryetari dhe anëtarët e pranishëm në mbledhje, në tri kopje, prej të cilave dy kopje administrohen përkatësisht nga SFI dhe Sekretari i Komitetit dhe kopja e tretë arshivohet.”

d. Në pikën 10, fjalia e dytë ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“10. Sekretari u shpërndan anëtarëve të Komitetit dokumentet dhe informacionet, që do të shqyrtohen në mbledhje, mban procesverbalet gjatë zhvillimit të tyre, kujdeset që dokumentet e miratuara të siglohen nga të gjithë anëtarët e Komitetit, si dhe ndjek shpërndarjen e këtyre dokumenteve të strukturat përgjegjëse për zbatim, si dhe arshivimin e tyre.”

4. Në nenin 9, shkronja “b” togfjalëshi “me Rregulloren “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 8, datë 30.04.2014” zëvendësohet me togfjalëshin “me Rregulloren “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 20, datë 25.09.2017 dhe/ose çdo akti ndryshues të tij;”

5. Në nenin 10, bëhen këto ndryshime:

a. shkronja “b” ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“b. realizon dhe ndjek transaksionet në tregjet vendase ose të huaja, në tregun primar dhe sekondar në zbatim të kësaj rregulloreje dhe të vendimeve të Komitetit të Investimeve;”

b. Pas shkronjës “h”, shtohet shkronja “i” me këtë përmbajtje:





- “i) raporton periodikisht në baza tremujore në Këshillin Drejtues aktivitetin investues për periudhën përkatëse dhe parashikimet për investimin e mjeteve financiare të Agjencisë për periudhën pasardhëse.”
6. Në nenin 13, pika 3, shkronjat “a”, “b” dhe “c” ndryshojnë me përmbajtjen e mëposhtme:
- a) Fitch Ratings A-
  - b) Standard & Poor’s A-
  - c) Moody’s Investors Service A3
7. Në nenin 14, pika 1, shkronja “b” togfjalëshi “një vlerë më të madhe se 30% e totalit të mjeteve financiare” zëvendësohet me togfjalëshin “një vlerë më të madhe se 40% e totalit të mjeteve financiare”.
8. Në nenin 17 bëhen këto ndryshime:
- a. Titulli i nenit ndryshon me këtë përmbajtje:  
“Investimi në tregjet e huaja dhe kriteret e përzgjedhjes së institucioneve financiare ndërkombëtare të kujdestarisë, tregtimit dhe ndërmjetësimit të titujve”
  - b. Shtohet pika 1, me përmbajtjen e mëposhtme, duke rinumërtuar pikat vijuese të këtij neni:  
“1. SFI kryen transaksionet e blerjes së titujve në tregje të huaja nëpërmjet institucioneve financiare të tregtimit (*dealer-it*) apo ndërmjetësimit të titujve (*broker-it*). Ruajtja e titujve të blerë nga Agjencia në tregjet e huaja, kryhet nga kujdestari i titujve i përzgjedhur sipas kriterëve në këtë rregullore.”
9. Në nenin 17/1, pika 2 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:  
“2. Komiteti i investimeve, kur e vlerëson të nevojshme, merr vendim për autorizimin e SFI që të kryejë veprime tregtimi blerje/shitje në tregun sekondar, të titujve të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Autoriteti Mbikëqyrës, në lek ose në monedhë të huaj, me bankat e nivelit të dytë ose institucione të tjera financiare, që operojnë në Republikën e Shqipërisë, veprimtaria e të cilëve mbikëqyret nga një autoritet rregullator.”

II. Ngarkohet Komiteti i Investimeve, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Analizës dhe Riskut për zbatimin e këtij vendimi.

III. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar

